




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

KA/Nr. 2907/20  
Datë: 23/11/2020

Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i themeluar me Vendimin Nr.1448/20D, ta datës 04.09.2020, në përbërje të Faton Merovci, Muhamet Qerimi dhe Krenare Sogojeva Dërmaku, në shqyrtimin e lëndës administrative, respektivisht ankesës Kosovo Art Academy e datës 20.08.2020, kundër Vendimit të KSHC Nr. 974/20D, të datës 21.07.2020 për refuzimin e kërkesës për riakreditimi institucional, e pranuar më datë 23.10.2020, në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e datës, 11.11.2020, me votim unanimit, mori këtë:

**VENDIM**

1. Pranohet si e bazuar ankesa e Kolegjit Kosovo Art Academy, e datës 20.08.2020 dhe shfuqizohet Vendimi i KSHC-së nr. 974/20D, datë 21.07.2020.
2. Obligohet AKA të filloj me organizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm me një ekip të pavarur të vlerësueseve ndërkombëtarë, ashtu siç parashihet me nenin 10, paragrafin 1.5.1 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditim të IAL-ve.

**ARSYETIM**

Kosovo Art Academy më datë 20.08.2020, brenda afatit ligjor ka parashtruar Ankesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, përmes së cilës ka kërkuar që Këshilli Shtetëror i Cilësisë të rishqyrtoj vendimin e tij të datës 21.07.2020, nr. 974/20D, me të cilin është refuzuar kërkesa për riakreditim institucional. Pala me Ankesën e datës 20.08.2020 pretendon se:

Këshilli Shtetëror i Cilësisë pa të drejtë ka refuzuar riakreditimin institucional duke konstatuar se plotëson kriteret për riakreditim institucional duke parashtruar provat për t'i mbrojtur pretendimet e veta.

**Provat e administruara:**

- Vendimi i KSHC-së Nr. 974/20D
- Njoftimi nga AKA i datës 20 Janar 2020;
- Raporti i KSHC-së për rishqyrtimin e ankesës nga takimi i datës 02.09.2020

## **Shpjegim i situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi**

Komisioni i Ankesave pranë AKA-së, ka pranuar ankesën e datës 20.08.2020 të Kosova Art Academy më datë 23.10.2020, së bashku me dokumentacionin dhe raportin e KSHC-së nga takimi i datës 02.09.2020, me të cilën ka përshkruar pretendimin e palës dhe arsyen e refuzimit të kërkesës për akreditim.

Komisioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura ka gjetur se:

KSHC pas verifikimit të dokumentacionit, ka vërtetuar se këta të fundit kanë dorëzuar Raportin e Vetëvlerësimit pas afatit të caktuar kohorë, gjë që është në kundërshtim me nenin 10. Pika 1.4.2. të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 15/2018 për akreditimin e IAL-ve.

Kosovo Art Academy pretendon se njoftimi i lëshuar nga AKA për përgatitjen e Raportit të vetëvlerësimit nuk ka qenë i qartë dhe i saktë, për çka ka vënë edhe në lajthitje institucionin në fjalë.

## **Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave**

Komisioni i Ankesave, pasi ka konstatuar se ankesa e Kosovo Art Academy është parashtruar brenda afatit kohor, ka shqyrtuar pretendimet e palës për refuzimin e ri-akreditimit institucional.

Komisioni i Ankesave e ka verifikuar njoftimin e lëshuar nga AKA për miratim formal të aplikacionit/kërkesës për ri-akreditim institucional dhe ri-akreditim të programeve. Në njoftim ndër të tjerash është thënë se: *“ Me ngjyrë të gjelbër janë të markuara programet të cilat janë të aprovuara dhe me ngjyrë të verdhë janë të markuara programet të cilat do të mund të diskutohen gjatë takimeve mes KSHC dhe IAL-ve”*. Nga dokumenti i bashkëngjitur me këtë njoftim, është vërtetuar se pjesa tek ri-akreditimin institucional nuk është markuar me asnjë ngjyrë, për çka pala është vënë në lajthitje se a duhet të dërgohet Raporti i vetëvlerësimit institucional, apo jo. Për këtë, Kolegji në fjalë ka paraqitur Raportin e vetëvlerësimit për ri-akreditim institucional, vetëm pasi është mbajtur takimi i KSHC-së, më datë 1 Prill 2020, pra pala ka dorëzuar raportin me 7 Prill 2020.

## **Baza ligjore e vendimit dhe arsyeja pse është e zbatueshme në rastin konkret**

Bazuar në nenin 10, paragrafi 1.4.2. të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, i cili përcakton se: *“ Me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës së vlerësuesve të jashtëm gjatë shqyrtimit të RVV-ve, dhe me qëllim që RVV-të të përmbajnë të dhëna të aktualizuara, RVV duhet të sillet në AKA, më së largu 1 muaj pas aprovimit formal të aplikacionit nga KSHC, Në rast se institucioni nuk arrin të dorëzoj RVV-në brenda afatit kohor prej një muaji, aplikacioni i institucionit procedohet në mbledhjen e KSHC-së për refuzim të aplikacionit”*.

Nga kjo, derisa është provuar se kërkesa për riakreditim institucional është refuzuar mbi bazën e lartcekur, Komisioni i Ankesave ka vërtetuar se mos paraqitja në kohë e RVV-së nga ana e institucionit në fjalë është rezultat i keqinformimit nga AKA dhe konstaton se dorëzimi i RVV-së me datë 7 Prill 2020 duhet të konsiderohet brenda afatit ligjor.

Pala me datë 29.10.2020, ka qenë e ftuar nga Komisioni i Ankesave për ta ushtruar të drejtën e vet për tu dëgjuar, ashtu siç e parasheh nenin 95 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kosovo Art Academy e ka realizuar këtë të drejtë dhe ka mbrojtur të njëjtat pretendime si në ankesë.


Në përfundim,

Komisioni i Ankesave pasi shqyrtimit dhe administrimit të provave, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi, mbi bazën e kompetencave të dhëna me nenin 22, paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Komisioni i Ankesave në AKA


KA/Nr. 2907/20, datë 25/11/2020

Procesmbajtësi



Arianit Krasniqi

Kryetari i Komisionit të Ankesave



Faton Merovci



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve në gjykatën kompetente për konfliktet administrative.